

KËRKESË
Nr. 31/7, datë 19.8.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Restaurimi dhe rijetësimi i ‘Sarajet e Libohovitëve’, Muzeu Etnografik i Tiranës”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “truall”, si dhe bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pasuritë e llojit “ndërtesë banimi”, konfirmuar me çmim mesatar shitblerjesh nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore, Tirana Veri, me shkresën nr. 2482/5 prot., datë 17.8.2021, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 505 843 802.6 (pesëqind e pesë milionë e tetëqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e dy pikë gjashtë) lekë.

KRYETAR I
KOMISIONIT TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Klodiana Guci

LLOGARITJET PARAPRAKE PËR PASURITË QË PREKEN NGA PROJEKTI “RESTAURIMI DHE RIJETËSIMI I ‘SARAJET E LIBOHOVITËVE’, MUZEU ETNOGRAFIK I TIRANËS”

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	ZK	Nr. i pas.	Sip. përgj. Truall (m²)	Sip. prekur truall (m²)	Çmimi për truall (lek/m²)	Vlera trualli i prekur (lek)	Sip. e gjurmës së objektit, sipas kartelës (m²)	Sip. e përgj. ndërtimi e objektit, sipas kartelës (m²)	Sip. prekur objekt (m²)		Çmimi për objekt banimi (lek/m²)	Vlera sip. e prekur objekt shërbimi, me situacion (lek)	Vlera sip. e prekur objekt banimi (lek)	Vlera e përgj. truall + objekt (lek)	Konfirmim nga ZVRPP-ja Tiranë dhe ASHK-ja Tiranë	Shënime
										Sip. shërbimi (m²)	Sip. banimi (m²)						
1	Shtet	8150	1/514	50.10	50.10	-	-	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	-	Shkresa nr. prot. 33660/1, datë 13.12.2017, e ZVRPP-së	Mungon seksioni E+D i kartelës
2	Leila Shefqet Libohova	8150	1/518	859	859.00	66,969.00	57,526,371.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	57,526,371	Shkresa nr. prot. 958/1, datë 26.1.2018, e ZVRPP-së	Ne pershkrimin e veçantë ka shënimin: Ka diferencë dokument-fakt 71 m2. Sipas dokumentacio nit ka 930 m2
3	Shtet	8150	1/97	114.70	114.70	-	-						0.00	0	-	Shkresa nr. prot. 33660/1, datë 13.12.2017, e ZVRPP-së	
4	BP. Mirashi, Libohova	8150	1/205	2489	2489	66,969.00	166,685,841.00	811	1622		1622.00	173,632.30	-	281,631,590.60	448,317,431.60	Shkresat nr. prot. 958/1, datë 26.1.2018, e ZVRPP-së dhe nr. prot. 2482/5, datë 17.8.2021, e ASHK-së, Drejt. Vend., Tirana Veri	Në pershkrimin e veçantë ka shënimin: “Banesë 2-katëshe, me 31 dhoma”.
	SHUMA				3512.8						1,622				505,843,802.60		

SHËNIM:

1. Pasuritë e prekura nga projekti, konfirmohen me shkresat nr. prot. 33660/1, datë 13.12.2017 dhe nr. prot. 958/1, datë 26.1.2018, të ZVRPP-së Tiranë.
2. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.
3. Për objektet me funksion banimi, çmimi për llogaritje është marrë çmimi mesatar për objekt banimi, vënë në dispozicionin tonë me shkresën nr. prot, 2482/5, datë 17.8.2021, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore, Tirana Veri.